

URDHËR
Nr. 173, datë 12.9.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe Rregullores së Brendshme të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, miratuar me urdhrin e Komisionerit nr. 46, datë 16.2.2024, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave për nënshkrimin e akteve administrative me karakter të përgjithshëm në kompetencë të titullarit/Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas legjislacionit të zbatueshëm dhe Rregullores së institucionit tek znj. Blerta Nerguti, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, duke filluar nga data 15.9.2025 deri më datë 19.9.2025.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtorët e Përgjithshëm pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**
Besnik Dervishi